


Anketa e Turizmit Pushime dhe Udhëtime, 2019

Tiranë, më 13 Nëntor 2020: Anketa e Turizmit në Familje, “Pushime dhe Udhëtime” është një vrojtim statistikor që kryhet pranë njësisive ekonomike familjare (NjEF) dhe ka objekt të gjithë individët mbi 15 vjeç me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri. Anketa mbledh të dhëna mbi udhëtimet me të paktën një natë fjetjeje për pushime, udhëtime pune dhe udhëtime të tjera, si dhe udhëtimet vajtje-ardhje, brenda dhe jashtë vendit.

Në vitin 2019, numri i udhëtimeve për qëllime personale apo biznesi (brenda apo jashtë Shqipërisë) të kryera nga individët banues në Shqipëri të moshës mbi 15 vjeç ishte 5.350.604. Numri mesatar i netëve të qëndrimit për udhëtime të kryera është 5,5 netë. Udhëtimet për qëllime personale përbëjnë 95,1 % të udhëtimeve gjithsej, ndërsa udhëtimet për qëllime biznesi 4,9 % të tyre. Mesatarisht në vitin 2019 një individ në Shqipëri ka kryer 2,3 udhëtime. Përqëndrimet më të larta të udhëtimeve të kryera janë regjistruar në muajt: Gusht (12,9 %), Mars (10,7 %), Qershor (9,9 %), Dhjetor (9,6 %) dhe Korrik (9,4 %). Siç vërehet edhe nga grafiku shuma e netëve të qëndrimit (në milion) ka regjistruar vlerat më të larta në muajt Gusht, Korrik dhe Maj.

Fig.1 Numri i udhëtimeve dhe shuma e netëve të qëndrimit sipas muajt të nisjes, 2019, në milion



Udhëtimet sipas qëllimit


Shpërndarja e udhëtimeve sipas qëllimit, në vitin 2019, ndjek të njëjtin trend me numrin e udhëtimeve. Në vitin 2019, janë regjistruar 17,8 % më shumë udhëtime në të gjithë Shqipërinë dhe jashtë saj, krahasuar me vitin 2018. Përgjithësisht është shënuar rritje për të gjitha llojet e udhëtimeve, ndërsa vetëm për udhëtimet për qëllime biznesi të kryera jashtë Shqipërie është shënuar rënie.

Tab.1 Shpërndarja e numrit të udhëtimeve sipas qëllimit, 2018 – 2019

Qëllimi i udhëtimit	2018		2019	
	Nr.udhëtime (në milion)	%	Nr.udhëtime (në milion)	%
Personale në Shqipëri	3,61	79,5	4,14	77,3
Personale jashtë Shqipërisë	0,73	16,1	0,95	17,8
Bznesi në Shqipëri	0,07	1,5	0,18	3,3
Biznesi jashtë Shqipërisë	0,13	2,9	0,08	1,6
Gjithsej	4,54	100,0	5,35	100,0


Në 2019, udhëtimet e kryera në Shqipëri për qëllime “Biznesi” dhe kategoria “Pushime dhe kohë të lirë” janë rritur me rreth 2,3 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2018.

Fig.2 Shpërndarja sipas qëllimit të udhëtimeve brenda dhe jashtë Shqipërisë, 2018-2019, në %



Nëse do të analizojmë shpërndarjen e udhëtimeve sipas kohëzgjatjes së netëve të qëndrimit , udhëtimet e shkurtra (1-3 netë) në Shqipëri zënë një peshë më të madhe (68,8 %) se udhëtimet e gjata (4+ netë). Ndryshe paraqitet situata për udhëtimet e kryera jashtë Shqipërisë ku peshën më të madhe të tyre e zënë udhëtimet e gjata (71 %).

Fig.3 Shpërndarja e udhëtimeve sipas kohëzgjatjes brenda dhe jashtë Shqipërisë, 2019, në %



Nëse do të analizojmë më në detaj kohëzgjatjen e udhëtimeve sipas qëllimit në Shqipëri dhe jashtë saj, vërejmë se udhëtimet për “Pushime dhe kohë të lirë” me kohëzgjatje të gjatë në Shqipëri dhe jashtë saj kanë një përqëndrim më të lartë përkatësisht 56,2 % dhe 52,8 %. Udhëtimet për “Vizita te të afërm dhe miq” kanë kohëzgjatje të shkurtër brenda vendit (82,7 %) dhe kohëzgjatje të gjatë jashtë vendit (84,2 %). Udhëtimet e kryera për qëllime biznesi kanë kohëzgjatje të shkurtër në Shqipëri (87 %) dhe të gjatë jashtë saj (80,8 %).


Tab.2 Shpërndarja e udhëtimeve sipas qëllimit, kohëzgjatjes brenda dhe jashtë Shqipërisë, 2019, në %

Kohëzgjatja e udhëtimit	Në Shqipëri				Jashtë Shqipërisë			
	Pushime dhe kohë e lirë	Vizita te të afërm dhe miq	Biznes	Të tjera	Pushime dhe kohë e lirë	Vizita te të afërm dhe miq	Biznes	Të tjera
Udhëtime të shkurtra	43,8	82,7	87,0	68,4	47,2	15,8	19,2	29,9
Udhëtime të gjata	56,2	17,3	13,0	31,6	52,8	84,2	80,8	70,1

Profili i udhëtarëve


Analizimi i udhëtimeve sipas grup-moshës në vitin 2019, na tregon se përqindjet më të larta të udhëtimeve brenda dhe jashtë Shqipërisë janë kryer nga grup-mosha 25-34 vjeç, ndjekur nga grup-moshat 45-54 vjeç dhe 55-64 vjeç.

Fig.4 Shpërndarja e udhëtimeve sipas grup-moshës brenda dhe jashtë Shqipërisë, 2019, në %




Analizimi i udhëtimeve sipas gjinisë së udhëtarit, në vitin 2019, na tregon se përqindjet më të larta të udhëtimeve brenda Shqipërisë janë kryer nga udhëtarët femra (51,4 %), ndërsa udhëtimet jashtë Shqipërisë janë kryer më shumë nga udhëtarët meshkuj (52,8 %).

Fig.5 Shpërndarja e udhëtimeve sipas gjinisë brenda dhe jashtë Shqipërisë, 2019, në %



Lidhur me kohëzgjatjen e udhëtimeve të analizuar sipas grup-moshave të udhëtarëve, në vitin 2019, vihet re që udhëtimet me kohëzgjatje të shkurtër (1-3 netë) kanë shënuar përqindjen më të lartë për grup-moshën 45-54 vjeç. Ndërsa udhëtimet me kohëzgjatje të gjatë (4+ netë) janë kryer nga grup-mosha 65-74 vjeç.


Fig.6 Shpërndarja e udhëtimeve sipas grup-moshës dhe kohëzgjatjes, 2019, në %



Udhëtimet sipas destinacioneve

Në vitin 2019, destinacionet më të preferuara për udhëtime për qëllime personale apo biznesi në Shqipëri janë qarqet: Tiranë (28,5 %), Korçë (12,3 %), Vlorë (11,6 %) dhe Durrës (10,3 %). Në udhëtimet e kryera jashtë Shqipërie përqindjet më larta janë regjistruar në: Greqi (6,6 %), Itali (5,5 %) dhe Kosovë (1,3 %).

Fig.7 Përqindja e udhëtimeve sipas destinacioneve më të frekuentuara në Shqipëri dhe jashtë saj 2019, në %



Nëse do të analizojmë udhëtimet e kryera në Shqipëri përgjatë tremujorëve të shpërndara sipas qëllimit “Pushime dhe kohë e lirë”, vihet re se në tremujorin e parë dhe të katërt është shënuar përqindja më e lartë e tyre në ato udhëtime që kanë si destinacion kryesor qarkun e Korçës përkatësisht 42,2 % dhe 35,3 %. Udhëtimet që kanë si destinacion kryesor qarkun e Durrësit kanë regjistruar përqindjen më të lartë të udhëtimeve në tremujorin e dytë 23,5 %, ndërsa në tremujorin e tretë është regjistruar si destinacion i preferuar qarku i Vlorës me 48,3 %. Në vitin 2019, destinacionet më të preferuara të udhëtimeve të kryera jashtë Shqipërisë për “Pushime dhe kohë të lirë” për tremujorin e parë janë: Greqia dhe Italia, për tremujorin e dytë: Italia dhe Turqia, në tremujorin e tretë: Greqia dhe Kosova dhe për tremujorin e katërt: Mali i Zi dhe Greqia.


Tab.3 Përqindja e udhëtimeve sipas destinacioneve më të frekuentuara në Shqipëri dhe tremujorëve për “Pushime dhe kohë të lirë”, 2019, në %

Tremujori:	I parë	I dytë	I tretë	I katërt
Në Shqipëri				
Berat	1,2	0,7	0,3	5,1
Dibër	0,7	0,5	0,1	2,5
Durrës	5,2	23,5	25,2	5,3
Elbasan	1,7	1,7	0,2	1,7
Fier	0,4	4,6	0,2	0,2
Gjirokastrë	4,4	-	0,3	1,3
Korçë	42,2	19,6	9,7	35,3
Kukës	0,8	4,1	1,4	4,4
Lezhë	1,2	0,7	2,5	1,5
Shkodër	3,6	6,3	5,8	2,8
Tiranë	8,5	23,1	6,0	33,6
Vlorë	30,0	15,2	48,3	6,2
Jashtë Shqipërisë				
Greqi	36,0	11,3	32,3	20,8
Itali	24,4	26,4	6,6	15,7
Gjermani	0,6	-	3,7	4,3
Turqi	6,3	20,3	9,3	5,5
Spanjë	0,9	1,5	4,0	-
Egjipt	-	-	2,0	1,3
Mali i Zi	8,4	7,0	6,9	25,8
Maqedonia e Veriut	5,3	5,3	3,2	7,3
Kosovë	5,0	11,8	19,3	11,5
SHBA	-	0,1	-	1,2
Tajlandë/Kanada/Dubai	-	1,0	-	-
Tjetër	13,0	15,3	12,7	6,7

Udhëtimet sipas llojit të akomodimit


Lloji më i shpeshtë i akomodimit në vitin 2019, është “të qëndruarit tek të afërmit apo miqtë”, ndjekur nga kategoria “hotel” dhe “ambiente akomodimi me qira” apo “shtëpi ose apartamente të dyta për pushime”. Në vitin 2019 vërehet rritje për kategorinë “ambiente akomodimi me qira” rreth 4,2 pikë përqindje, ndërkohë ulje është regjistruar për kategorinë “hotel” me 2,9 pikë përqindje.

Fig.8 Shpërndarja udhëtimeve sipas llojit të akomodimit, 2018 - 2019, në %



Për të gjitha llojet e udhëtimeve të kryera brenda dhe jashtë Shqipërisë, në vitin 2019 pesha më e lartë sipas llojit të akomodimit është regjistruar për kategorinë “qëndrim tek të afërmit ose miqtë”, ndjekur nga kategoria “hotel”.

Fig.9 Shpërndarja e udhëtimeve brenda dhe jashtë Shqipërisë sipas llojit të akomodimit, 2019, në %



Numri i udhëtimeve të kryera nga udhëtarët për qëllime personale në Shqipëri dhe jashtë saj është 5,09 milion për të cilët opsioni më i preferuar i akomodimit është “qëndrimi tek të afërmit ose miqtë”. Ndërsa në udhëtimet e kryera për qëllime biznesi si në Shqipëri dhe jashtë saj të cilat janë rreth 0,26 milion, “hoteli” është forma më e shpeshtë e akomodimit.

Tab.4 Shpërndarja udhëtimeve brenda dhe jashtë Shqipërisë sipas qëllimit dhe llojit të akomodimit, 2019, në %

Qëllimi i udhëtimit:	Hotel	Shtëpi ose apartamente të dyta për pushime	Ambiente akomodimi me qira	Qëndrim tek të afërmit ose miqtë	Shtëpi pushimi,druri, kamping, (SPA,lixa) etj
Personale në Shqipëri	16,5	4,0	9,1	67,6	2,8
Personale jashtë Shqipërisë	31,5	0,5	4,6	59,9	3,4
Biznesi në Shqipëri	38,9	17,5	2,9	37,7	3,0
Biznesi jashtë Shqipërisë	46,5	2,5	32,1	18,9	-
Gjithsej	20,4	3,8	8,5	64,5	2,9

Për të gjitha llojet e udhëtimeve të kryera në Shqipëri shfaqen format të ndryshme të akomodimit në qarqe. Udhëtimet në të cilat janë regjistruar përqindjet më të larta të akomodimit në “hotel” kanë si destinacion qarkun Vlorë dhe Korçë , akomodimi në “ambjente me qira” dhe “shtëpi apo apartamente të dyta “ është raportuar në udhëtimet që kanë si destinacion qarqet: Durrës dhe Vlorë.

Tab.5 Shpërndarja e udhëtimeve brenda Shqipërisë dhe llojit të akomodimit, 2019, në %


Qarku	Hotel	Shtëpi ose apartamente të dyta për pushime	Ambiente akomodimi me qira	Qëndrim tek të afërmit ose miqtë	Shtëpi pushimi,druri, kamping, (SPA,lixa) etj
Berat	2,1	-	0,1	2,3	1,2
Dibër	0,2	-	0,2	2,5	1,0
Durrës	8,5	15,9	42,5	9,9	8,1
Elbasan	0,8	0,9	0,3	3,8	1,4
Fier	0,4	13,7	0,2	4,4	1,7
Gjirokastër	1,6	0,2	0,5	2,6	1,8
Korçë	29,4	14,1	5,1	12,9	16,0
Kukës	3,0	1,1	0,3	3,6	3,3
Lezhë	1,5	1,1	2,0	4,3	1,6
Shkodër	4,9	5,6	8,5	2,5	2,9
Tiranë	9,8	14,0	6,3	47,1	40,7
Vlorë	37,7	33,3	34,2	4,1	20,3

Sa i përket udhëtimeve të kryera jashtë Shqipërisë, akomodimet në “hotel” paraqesin përqindjet më të larta për destinacionet si Greqi, Mal i Zi, Itali dhe Turqi. Akomodimi tek “të afërmit apo miqtë” paraqitet më shpesh në udhëtimet që kanë si destinacion Greqinë dhe Italinë.

Udhëtimet sipas llojit të transportit

Rreth 4,8 milionë udhëtime janë kryer nëpërmjet transportit rrugor të cilët përbëjnë 90,2 % të të gjithë udhëtimeve të kryera në vitin 2019. Rritja më e lartë është regjistruar në transportin rrugor nëpërmjet makinave private me 5,9 pikë përqindje ndjekur nga transporti ajror me 2,1 pikë përqindje dhe ulje është regjistruar në transportin rrugor nëpërmjet autobuza/mikrobuza me 7,0 pikë përqindje.

Fig.10 Shpërndarja udhëtimeve sipas mënyrës së transportit, 2018-2019, në %



Format e rezervimit

Në rezervimet e kryera, për të gjitha llojet e udhëtimeve të kryera në Shqipëri vihet re se: për rezervimet mbi llojin e transportit përqindjet më të larta regjistrohen për udhëtimet të cilat kanë si destinacion qarqet Tiranë (19,8 %) dhe Vlorë (31,1 %). Ndërsa përqindjet më të larta të rezervimeve mbi format e akomodimit paraqiten në udhëtimet që kanë si destinacion Korçën (20,1 %) dhe Vlorën (38,8 %). Sa i përket udhëtimeve të kryera jashtë Shqipërisë përqindjet më të larta të rezervimeve si për llojin e transportit ashtu dhe për format e akomodimit janë regjistruar për udhëtimet me destinacion: Italinë, Greqinë dhe Turqinë.

Udhëtimet një ditore (vajtje-ardhje)

Nëse do të analizojmë udhëtimet një ditore sipas qëllimit (personale apo biznesi) brenda dhe jashtë Shqipërisë, vërehet se në tremujorin e katërt është shënuar numri më i lartë i udhëtimeve për qëllime personale dhe biznesi në Shqipëri, ndërsa udhëtimet për qëllime personale jashtë Shqipërisë janë kryer më shumë në tremujorin e parë dhe ato për qëllime biznesi në tremujorin e katërt.


Tab.6 Shpërndarja e udhëtimeve një ditore (vajtje-ardhje) sipas tremujorëve dhe qëllimit 2019

Tremujori	Shuma e udhëtimeve një ditore (vajtje-ardhje) (në nr.)			
	Për qëllime personale		Për qëllime biznesi	
	Në Shqipëri	Jashtë Shqipërisë	Në Shqipëri	Jashtë Shqipërisë
I	6.692.967	302.557	1.907.778	166.124
II	7.811.545	231.137	2.295.546	101.208
III	8.361.353	208.365	2.954.626	429.290
IV	12.436.231	257.497	6.377.151	466.298
Gjithsej	35.302.096	999.556	13.535.100	1.162.920

Vendi i origjinës së udhëtimeve

Rreth 25 % e udhëtimeve si brenda dhe jashtë vendit si vend origjinë kanë qarkun e Tiranës, nga të cilët 23,4 % janë udhëtime në Shqipëri dhe 31,1 % janë udhëtime jashtë saj.

Fig.11 Shpërndarja udhëtimeve brenda dhe jashtë Shqipërisë sipas vendit të origjinës, 2019, në %



Metodologjia

Anketa e Turizmit në Familje. "Pushime dhe Udhëtime" është një vrojtim statistikor që kryhet pranë njësisive ekonomike familjare (NjEF) dhe ka objekt të gjithë individët me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri mbi 15 vjeç. Anketa mbledh të dhëna mbi udhëtimet me të paktën një natë fjetjeje për pushime, udhëtime pune dhe udhëtime të tjera, si brenda dhe jashtë vendit, gjithashtu edhe ato brenda ditës brenda/ jashtë vendit të ndarë në katër tremujorë përkatësisht: Tremujori i parë (Janar-Mars), tremujori i dytë (Prill-Qershor), tremujori i tretë (Korrik-Shtator), tremujori i katërt (Tetor-Dhjetor). Anketa e Turizmit në Familje. "Pushime dhe Udhëtime" u krye për herë të parë në vitin 2017 përgjatë gjithë vitit me një kampion përfaqësues për të gjithë Shqipërinë.

Në vitin 2019, Anketa e Turizmit në Familje. "Pushime dhe Udhëtime" u krye me një kampion prej 10.240 NjEF, ku për çdo tremujor anketa përfshin një kampion prej 2.560 familjesh ose 320 PSU.

Në përfundim të vrojtimit u intervistuan rreth 8.010 NjEF të shpërndara në mënyrë uniforme në të gjithë territorin e Shqipërisë. Shkalla e përgjigjes së NjEF, e llogaritur si raport i numrit të NjEF që kanë plotësuar anketën ndaj numrit të NjEF të zgjedhura, shprehur në përqindje rezultoi 78.2 %.

Zgjedhja e kampionit bëhet sipas një procedure dy-hapëshe. Njësitë e hapit të parë (PSU) janë zonat e Censit të homogjenizuara, me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së Censit. Në hapin e dytë, brenda secilës prej zonave të zgjedhura në hapin e parë, zgjidhen sipas metodës së zgjedhjes sistematike me probabilitet të barabartë një numër fiks prej 8 NjEF. Zgjedhja në të dyja hapat është bërë në mënyrë të rastësishme.

Mbledhja e të dhënave:

Kryhet një interviste direkte nga anketuesit me pyetësor letër ku përfshihen pyetje për familjen dhe të dhënat bazë në lidhje me të si dhe realizohet intervistë individuale për çdo person prezent në NjEF mbi 15 vjeç.

Struktura e pyetësorit:

- Informacion i përgjithshëm;
- Karakteristikat demografike të anëtarëve të NjEF-së;
- Pyetësori Individual (karakteristika socio-demografike, numri dhe karakteristikat e udhëtimeve me fjetje dhe udhëtimet një ditore).

Përkufizime:

Turizmi është veprimtaria e vizitorëve duke ndërmarrë një udhëtim për një destinacion kryesor jashtë vend-banimit të zakonshëm ku jeton. për më pak se një vit. për çfarëdo qëllimi kryesor. duke përfshirë biznesin, kohën e lirë apo qëllime tjera personale. Personi vizitor nuk duhet të jetë i punësuar nga një subjekti rezident në vendin e vizituar.

Vizitor është klasifikuar një turist (ose vizitori për një ose më shumë netë), në qoftë se udhëtimi i tij / saj përfshin një qëndrim me fjetje.

Vizitor një ditë është një udhëtar ose turist i cili nuk qëndron gjatë natës në vendin ku ka udhëtuar.

Udhëtar do të konsiderohet individ i cili lëviz në vendeve të ndryshme gjeografike për çdo qëllim dhe kohëzgjatje.

Udhëtimi i referohet veprimtarisë së udhëtarëve.

Turizëm i brendshëm. përfshin aktivitetet e një vizitori rezident brenda vendit.

Turizëm i jashtëm. përfshin aktivitetet e një vizitori rezident jashtë vendit të referencës.

Udhëtim për qëllime personale: Udhëtime për qëllime personale janë ato udhëtime jashtë vend-banimit të zakonshëm të individit. të cilat përfshijnë të paktën një ose më shumë netë dhe nuk i kalojnë 12 muaj.

Udhëtim për qëllime biznesi ose pune: Udhëtime për qëllime biznesi janë ato udhëtime jashtë vend-banimit të zakonshëm të individit. të cilat përfshijnë të paktën një ose më shumë netë dhe nuk i kalojnë 12 muaj (kongrese dhe konferenca. panairë dhe ekspozita. bisedime për biznes dhe misione (shitje ose blerje), udhëtime profesionale (të ndërmarrura nga përfaqësuesit e kulturës apo religjionit. etj). trajnimin. shoqërimin e personave të tjerë. etj).

Destinacioni kryesor: në rastin e një udhëtimi jashtë vendit. individ deklaron se ku ka qëndruar. Në qoftë se udhëtarin nuk është në gjendje për të vendosur, udhëtarin do vendosë si destinacionin kryesor vendin ku ai ka shpenzuar kohën më të madhe të netëve të qëndrimit; në qoftë se ka shumë vende me numër të njëjtë të qëndrimeve me fjetje atëherë do vendoset destinacioni më i largët apo vendi ku udhëtarin ka shpenzuar më shumë para.

Netët e qëndrimit: janë netët e qëndrimit në një hotel ose ambjent i ngjashëm. në një banesë private me qira ose jo me qira (akomodimi ofrohet nga miqtë apo të afërmit). ose në natyrë (kamping). Gjithashtu në netët e qëndrimit janë të përfshira netët e kaluara në mjetet e udhëtimit (në tren. autobus).

Kohëzgjatja e udhëtimit: Numri i netëve të qëndrimit.

Qëllimi kryesor i udhëtimit: Qëllimi kryesor i udhëtimit është ai që i përshtatet më mirë sipas të intervistuarit. Është shumë e rëndësishme që të veçohen udhëtimet për qëllime personale nga ato për biznes ose punë.